



UNIVERSITETI I PRISHTINES

FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Edukimit

Udhëzues për rishikim të kurseve

Nëntor 2023

I. Hyrje

Ky dokument, miratuar nga Këshilli i Fakultetit në mbledhjen e datës 30/11/2023, shërben për stafin akademik të Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës për të mbështetur procesin e rishikimit të kurseve me qëllim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit. Ndryshimet e shpejta që po ndodhin në arsimin e lartë, sidomos lëvizja drejt mësimdhënies me studentin në qendër e intensifikuar shumë në dekadat e fundit, kërkojnë ndryshime në praktikat e planifikimit dhe implementimit të mësimdhënies si dhe vlerësimit të arritjeve të studentëve mësimdhënës. Prandaj, ky dokument shërben si udhëzues për të gjithë stafin akademik të cilët dëshirojnë të reflektojnë rreth planifikimit dhe realizimit të kurseve të tyre me qëllim të përmirësimit të praktikave të mësimdhënies duke adaptuar dhe përvetësuar standardet e mira që lidhen me sigurimin e cilësisë. Gjithashtu, si pjesë e politikave të sigurimit cilësisë, synohet që të rishikohen në mënyrë të vazhdueshme vlefshmëria, relevanca, aktualiteti dhe rëndësia e objektiveve dhe përmbajtjes së kursit, dhe të rishikohet efektiviteti i strategjive mësimore të përdorura gjatë realizimit të kurseve, me fokus të veçantë në metodologjinë e mësimdhënies, realizimin e aktiviteteve mësimore, dhe vlerësimin e studentëve.

Formulari i dizajnuar më poshtë mund të përdoret individualisht nga stafi akademik i cili rishikon syllabusin para fillimit të ligjeratave ose në nivel aktiviteti profesional për lëndët e përafërta, por mund të përdoret edhe në nivel departamenti dhe programi me qëllim të harmonizimit të përmbajtjeve dhe metodave të mësimdhënies dhe të nxënit midis kurseve.

II. Udhëzime praktike për rishikimin e kursit

Më poshtë është paraqitur një formular me disa pyetje për t'i konsideruar gjatë rishikimit të kursit. Pas plotësimit të formularit rekomandohet që të analizohen përgjigjet dhe të identifikohen elementet e kursit të cilat kanë nevojë për modifikim. Formulari do të jetë edhe më i dobishëm nëse përdoret në grupe të syllabuseve të lëndëve të përafërta të cilat do të mund të rishikoheshin edhe për harmonizimin e përmbajtjeve, ndërlidhjen midis kurseve, koherencën, mbulueshmërinë e teorive, fenomeneve, koncepteve etj, me qëllim të promovimit të filozofisë së përgjithshme dhe synimet e programit si tërësi. Ky formular ka për synim trajtimin e aspekteve metodologjike më shumë dhe nuk fokusohet me përmbajtjet e rezultateve të pritura, koncepteve të trajtuara në kurse apo edhe të gjitha temave ndërkurrikulare. Pra, në kushte ideale shoqërohet edhe me pika më përmbajtësore referimi për cilësinë dhe përmbajtjen e programit dhe kurseve që janë në rishikim dhe analizë.

III. Formulari për rishikim të syllabuseve

I. Qëllimet e kursit dhe përmbajtja <i>(vlerëso deklaratat më poshtë me shkallë 1-5, ku 1-aspak, 5- shumë)</i>					
1. Qëllimet pasqyrojnë përmbajtjen e kursit dhe objektivat e programit.	1	2	3	4	5
2. Qëllimet dhe përmbajtja e kursit ka ndërlidhje me kurset e tjera të ngjashme.	1	2	3	4	5
3. Qëllimet dhe përmbajtja e kursit është në harmoni dhe koherencë me kurset e tjera të ngjashme (nëse është e zbatueshme).	1	2	3	4	5
Komente:					
II. Rezultatet e të nxënit <i>(vlerëso deklaratat më poshtë me shkallë 1-5, ku 1-aspak, 5- shumë)</i>					
4. Rezultatet e të nxënit të kursit ndërlidhen me rezultatet e të nxënit të programit.	1	2	3	4	5
5. Janë planifikuar rezultate që kërkojnë zbatimin e njohurive dhe të kuptuarit.	1	2	3	4	5
6. Janë planifikuar rezultate që kërkojnë të mënduarit e në nivel të gjykitimit/vlerësimit nga ana e studentëve.	1	2	3	4	5
7. Janë planifikuar rezultate që synojnë zhvillimin e shkathtësive të mësimdhënies dhe të nxënit.	1	2	3	4	5
8. Janë planifikuar rezultate që synojnë zhvillimin e shkathtësive të komunikimit.	1	2	3	4	5

9. Janë planifikuar rezultate që synojnë zhvillimin e vlerave.	1	2	3	4	5
Komente:					
III. Metodatat e mësimdhënies dhe të nxënësve <i>(vlerëso deklaratat më poshtë me shkallë 1-5, ku 1-aspak, 5- shumë)</i>					
10. Metodatat e planifikuara të mësimdhënies përshkruhen me rezultatet e pritura.	1	2	3	4	5
11. Janë planifikuar forma të ndryshme të punës duke kombinuar punën frontale, individuale, në çift dhe në grupe.	1	2	3	4	5
12. Janë përdorur metoda të mësimdhënies me studentit në qendër. <i>(shih listën e metodave në fund të këtij dokumenti si sugjerim/ide)</i>	1	2	3	4	5
12.1. Nëse po, cilat metoda janë përdorur?					
13. Sa % e kohës së ligjëratave parasheh që ju të mbani leksion?	_____%				
14. Sa % e kohës parasheh që studenti të jetë aktiv në të nxënë?	_____%				
15. Sa % e kohës është paraparë që studenti të merr rolin e mësimdhënësit (Ang: mock teaching).	_____%				

Komente:

IV. Materialet/burimet mësimore

(vlerëso deklaratat më poshtë me shkallë 1-5, ku 1-aspak, 5- shumë)

16. Materialet dhe burimet e përdorura janë aktuale dhe relevante.	1	2	3	4	5
17. Literatura është e përditësuar (p.sh. artikuj më relevant me të gjetura më të reja/aktuale, autor më relevant, teori të reja etj.)	1	2	3	4	5
18. Është planifikuar përdorimi i teknologjisë për mësimdhënie më efektive.	1	2	3	4	5
19. Është planifikuar përfshirja e studentëve në të nxënit e tyre duke përdorur mjete të ndryshme të teknologjisë.	1	2	3	4	5
20. Është planifikuar shfrytëzimi i burimeve dhe platformave online për të përmirësuar komunikimin me studentë (komunikimin profesor-student dhe studentë mes vete).	1	2	3	4	5
21. Janë përgatitur fletë-pune në të cilën do të punojnë studentët.	1	2	3	4	5
22. Studentëve do të ju oforhen artikuj hulumtimi për të lexuar, analizuar, krahasuar, vlerësuar etj.	1	2	3	4	5
23. Materiali që do të ofrohet mundëson të nxënit në bashkëpunim dhe komunikim të ndërsjellë midis kolegëve (studentë).	1	2	3	4	5

Komente:

V. Mësimdhënia gjithëpërfshirëse

(vlerëso deklaratat më poshtë me shkallë 1-5, ku 1-aspak, 5- shumë)

24. Janë planifikuar strategji të mësimdhënies të cilat sigurojnë adresimin e nevojave të studentëve me stile të ndryshme të të mësuarit.	1	2	3	4	5
25. Janë planifikuar strategji të mësimdhënies të cilat sigurojnë adresimin e nevojave të studentëve me sfond (background) të ndryshëm kulturor?	1	2	3	4	5

Komente:

VI. Të nxënit

(vlerëso deklaratat më poshtë me shkallë 1-5, ku 1-aspak, 5- shumë)

26. Studentët kanë mundësi të përvetësojnë njohuritë më të rëndësishme të kursit <i>(referojuni vlerësimin të fundit të studentëve si dhe pikave referuese për përmbajtjen e kursit tuaj)</i>	1	2	3	4	5
27. Studentët kanë mundësi të zhvillojnë shkathtësi ndërpersonale (komunikimit, punë ekipore, prezantimit, negocimit, zgjidhje të problemeve, vendim-marrje etj.) gjatë kursit.	1	2	3	4	5

28. Studentët kanë mundësi të zhvillojnë shkathhtësitë hulumtuese, analitike, dhe të menduarit kritik gjatë kursit.	1	2	3	4	5
29. Studentët kanë mundësi të zhvillojnë vlerat, krijojnë qëndrime dhe besime gjatë kursit.	1	2	3	4	5
Komente:					
VII. Vlerësimi dhe reflektimi <i>(vlerëso deklaratat më poshtë me shkallë 1-5, ku 1-aspak, 5- shumë)</i>					
30. Metodatat e planifikuara të vlerësimit lidhen me rezultatet e të nxënësve.	1	2	3	4	5
31. Vlerësimi i studentëve është planifikuar të jetë:	Formativ		Sumativ		
32. Nëse është planifikuar vlerësimi sumativ, zgjedh format e vlerësimit.	a) Teste periodike gjatë semestrit b) Test përfundimtar në fund të semestrit c) Projekt d) Detyra periodike me pikëzim të caktuar e) Kombinim i testeve dhe detyrave të tjera me pikëzim të caktuar				
33. Nëse është planifikuar vlerësimi formativ, zgjedh format e vlerësimit.	a) Feedback (informata kthyesë) b) Portfolio c) Vlerësim i ndjersjellë ç) Vetëvlerësimi d) Tjetër: _____				
34. Janë planifikuar kritere të qarta të vlerësimit të kursit dhe detyrave në vecanti.	1	2	3	4	5

35. Janë planifikuar metoda të reflektimit mbi mësimdhënien pas përfundimit të orës së ligjërates.	1	2	3	4	5
35.1. Nëse po rretho cilat!	a) Tiketa dalëse b) Sondazh/pyetësor për studentët c) Ditar reflektues d) Diskutim reflektues me studentë (në fund të ligjërates) e) Tjetër: _____				
Komente:					
VIII. Komunikimi dhe mbështetja e studentëve <i>(vlerëso deklaratat më poshtë me shkallë 1-5, ku 1-aspak, 5- shumë)</i>					
36. Janë prezantuar informata për studentët rreth mënyrave të komunikimit me profesorin e kursit.	1	2	3	4	5
37. Janë planifikuar orë të mjaftueshme për konsultime me studentët.	1	2	3	4	5
38. Janë planifikuar orë për të mbështetur studentët gjatë realizimit të obligimeve të kursit (p.sh. me udhëzime shtesë, me ofrimin e materialeve shtesë/alternative, me komente kthyesë para dorëzimit final të detyrave etj.)	1	2	3	4	5
Komente:					

Reflektim i përgjthshëm

(bazuar në vlerësim më lartë, identifikoni pjesët me të cilat jeni të kënaqur dhe ato për të cilat konsideroni se kanë nevojë për modifikim)

Elementet e kursit me të cilat jam i/e kënaqur	
Elementet e kursit të cilat duhen rishikuar dhe modifikuar	

IV. Definimi I koncepteve kryesore

IV. i. Metodologjia e Mësimdhënies

Metodologjia e mësimdhënies përfshinë teknika të ndryshme të cilat ndihmojnë studentët të arrijnë rezultatet e të nxënit. Pavarësisht teknikave të përdorura, elementi kryesor që duhet të konsiderohet gjatë planifikimit të realizimit të kursit është të nxënit aktiv që nënkupton seaktivitetet e realizuara gjatë kurist janë interaktive dhe ofrojnë mundësi studentëve të ndërlihdin aspektin teorik me atë praktik në situata të jetës reale.

Metodologjia e mësimdhënies me studentin në qendër që mundëson të nxënit aktiv, ndihmon studentët që të përvetësojnë përmbajtjen e një kursi të caktuar, mësojnë si ta aplikojnë përmbajtjen në situata reale, dhe zhvillojnë shkathtësitë ndërpersonale. Gjithashtu, rezultatet e të nxënit përveç njohurive akademike, ndërlihdhen edhe me shkathtësi gjenerale të cilat duhet t'i zhvilloj studentit si p.sh. shkathtësitë e të menduarit kritik, shkathtësitë e komunikimit efektiv, shkathtësitë analitike, etj. Prandaj, përveç zotërimit të njohurive të kursit, përvoja gjatë studimeve duhe të zhvilloj tek studentët shkathtësi të cilat janë të nevojshme për tregun e punës dhe karrierën e tyre në të ardhmen.

Metodologjia e mësimdhënies e cila përdoret gjatë realizimit të kursit duhe të jetë në harmoni me rezultatet e të nxënit. Një metodologji efektive e mësimdhënies duhet t'i ketë këto elemente:

- Ligjerata apo përmbajtja ofrohet në mënyrë interesante dhe tërheqëse
- Përmbajtja është e organizuar mirë dhe lehtë për t'u ndjekur. Studentët kuptojnë rrjedhën apo renditjen e informacionit
- Studentët ndihen të përfshirë në ligjëratë duke qënë pjesëmarrës aktiv. Kjo mund të arrihet p.sh. duke përdorur shembuj përkatës me të cilët ata mund të ndërlihdhen, duke parashtruar pyetje studentëve rreth temës e cila diskutohet
- Studentët marrin njohuri të reja pas përfundimit të ligjeratës dhe frymëzohet për të mësuar më shumë në ligjeratën tjetër.

Më poshtë janë paraqitur disa metoda mësimore të cilat mund të përdoren nga mësimdhënësit. Metodatat e mësimdhënies ndryshojnë në qasjen e tyre prandaj metodatat e përshtatshme zgjedhen nga mësimdhënësi vaësisht nga rezultatet e përcaktuara të të nxënit.

Ligjëratat janë një mjet efektiv i të mësuarit ku mësimdhënësit ligjërojnë përmbajtjen e lëndës përderisa studentët janë marrës të informatave. Edhe pse kjo metodë e mësimdhënies ka mësimdhënësin në qendër, ligjëratat janë efektive kur janë interaktive dhe nxisin pjesëmarrje aktive të studentëve. Kjo mund të arrihet në mënyra të ndryshme:

- Duke parashtruar pyetje për studentët për t'i diskutuar në grupe të vogla, për të marrë më pastaj komente nga disa grupe rreth asaj se çfarë mendojnë ata
- Duke kërkuar nga studentët të trajtojnë problemet në mënyrë individuale dhe pastaj të krahasojnë përgjigjet me kolegët e tyre

- Duke vendosur pyetje me opsione në mes të ligjeratës të cilave studentët duhet t'iu përgjigjen. Kjo mund të bëhet përmes ngritjes së duarve ose duke përdorur sistem elektronik të votimit. Studentët pyeten pse kanë zgjedhur njërin apo tjetrin option dhe diskutojnë me mësuesin për t'i sqaruar informatat e reja
- Duke i treguar një video që lidhet me temën dhe duke i udhëzuar studentët të kërkojnë dicka specifike për të cilën do të pyeten apo diskutojnë më pas.
- Duke realizuar një kuiz në fillim dhe në fund të orës me pyetje që kanë të bëjnë me temën e cila do të diskutohet, dhe duke analizuar progresin apo avancimin e njohurive.
- Duke kërkuar nga studentët të reflektojnë për 1-2 minuta dhe të shkruajnë 1-2 pyetje lidhur me ligjeratën
- Duke kërkuar nga studentët të ndajnë mendime, ide, ngjarje etj. që i vjen në mendje lidhur me temën e ligjeratës të cilat pastaj diskutohen në mënyrë kritike

Diskutimi në grup është një metodë që nxit të mësuarit përmes punës grupore dhe i lejon studentët të flasin për përvojat e tyre dhe të ndajnë idetë me të tjerët. Kjo metodë zhvillon te studentët aftësitë për dëgjim, për të kuptuar, për të sintetizuar dhe analizuar. Për të rritur motivimin dhe për të krijuar një mjedis argëtues dhe pozitiv, mësuesit mund t'i bëjnë grupet të konkurrojnë në detyra të ndryshme mësimore në klasë.

Mësimi i bazuar në raste është një qasje e përdorur në të gjithë disiplinat ku studentët zbatojnë njohuritë e tyre në situata reale, duke promovuar nivele më të larta të njohjes të përcaktuara sipas Taksonomisë së Blumit. Me këtë metodologji studentët zakonisht punojnë në grupe në studime të rasteve, raste që përfshijnë skenare apo çështje të ndryshme. Rastet paraqesin një problem në një fushë të caktuar për të cilën studentët gjejnë zgjidhje nën udhëheqjen e mësuesit. Kjo metodë përfshin hulumtime të drejtuara dhe bazohet në konstruktivizëm, ku studentët formojnë kuptime të reja duke ndërvepruar me njohuritë e tyre dhe mjedisin. Rastet në të cilat studentët punojnë duhet të jenë situata që janë shumë të lidhura me atë që mësohet në kursin e caktuar dhe duhet të shtyjnë studentët të marrin vendime të cilat do të duhej t'i marrin në jetën reale.

Mësimi i bazuar në kërkim është një proces mësimor që angazhon studentët të mësojnë aktivisht duke krijuar lidhje me botën reale përmes eksplorimit dhe pyetjeve të formuluar për zgjidhjen apo eksplorimin e thukët të një problemi ose fenomeni. Është një qasje ndaj të nxënies që inkurajon studentët të angazhohen në gjetjen e informatave të reja, analizë të të dhënave, dhe sintetizim të njohurive për të ofruar përgjigje ndaj problemit të hulumtuar duke aplikuar njohuritë e marra në klasë si bazë mbi të cilat ndërtohen konkludimet e arritura.

Klasa e kthyer (Flipped Classroom) është një model pedagogjike ku elementet e ligjërimit dhe të detyrave të shtëpisë të një kursi të caktuar janë të kundërta. Kjo nënkupton që studentët përgatisin materialin për një temë të caktuar të kursit në shtëpi, përpara se të shkojnë në ligjerata dhe pastaj mësuesi në ligjerata i kushohet diskutimit dhe aktivitetet rreth asaj teme. Pra studentët përgatiten me njohuri për temën e caktuar para ligjeratës dhe pastaj diskutojnë mbi atë që kanë punuar në shtëpi përderisa mësuesi e faciliton diskutimin dhe e plotëson me informata relevante dhe të detajuara për njësinë mësimore.

Të mësuarit përmes përvojës (experiential learning) është një proces i angazhuar mësimor ku studentët “mësojnë duke bërë” dhe duke reflektuar mbi përvojën e tyre. Aktivitetet e të mësuarit përmes përvojës mund të përfshijnë, punë laboratorike, punë praktike, aktivitete jashtë klasës, hulumtime, dhe punë vullnetare (service learning). Të mësuarit përmes përvojës ofron mundësi që studentët të ndërlidhin teorinë me praktikën duke u angazhuar në situata të jetës reale, promovon të mësuarit ndërdisiplinor, promovon zhvillimin e shkathtësive gjenerike të cilat rrisin punësueshmërinë e studentëve, dhe promovon angazhimin qytetar.


Mësimdhënia e simuluar (mock teaching) është një aktivitet që bëhet për të përgatitur studentët për t'u bërë mësues, që do të thotë se është një proces në të cilin dikush angazhohet në një skenar ku atyre u kërkohet të supozojnë se grupi i tyre i kolegëve janë vet nxënësit dhe të zhvillojnë një mësim. Kjo është fazë shumë e veçantë ku studentët priren ta vendosim veten në pozitën e një "Mësimdhënësi".

IV.ii. Teknikat e mësimdhënies

Varësisht nga metodologjia e mësimdhënies, gjatë realizimit të kursit mund të planifikohen aktivitete të ndryshme që përshtaten me përmbajtjen e ligjëratës dhe rezultatet e të nxënës. Aktivitetet e planifikuara dhe realizuara gjatë kursit mund të jenë të kategorive të ndryshme, p.sh. aktivitete që mundësojnë ligjëratë interaktive, të bazuar në diskutim/debat, ligjëratë që mundëson punë grupore, të bazuara në kërkim dhe përvojë jashtë klasës. Në Shtojcën 1 janë paraqitur disa shembuj të aktiviteteve të cilat mund të realizohen gjatë një kursi për të mundësuar mësimdhënie efektive dhe relevante.

IV.iii. Vlerësimi

Vlerësimi i të nxënës të studentëve është një aspekt integral i realizimit të kursit dhe shërben gjithashtu si masë e sigurimit të cilësisë. Vlerësimi është efektiv nëse metodat e vlerësimit janë në përputhje me rezultatet e të nxënës, mund të konfirmojnë të gjitha rezultatet e specifikuar të të nxënës janë arritur dhe se notat e dhëna reflektojnë nivelin e arritjeve të studentëve. Prandaj, është e rëndësishme të hartohen rezultatet e të nxënës në përputhje me detyrat e vlerësimit dhe strategjitë e mësimdhënies, dhe të krijohen mundësi për studentët që të përdorin përvojat e të nxënës për të arritur rezultate të matshme. Rezultatet e të nxënës mund të përdoren për të reflektuar rreth modifikimit të teknikave të mësimdhënies me qëllim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënës. Lidhja në mes të rezultateve të të nxënës dhe modifikimit të praktikave të mësimdhënies është paraqitur më poshtë grafikisht:



Kur merren parasysh metodat e vlerësimit, është veçanërisht e dobishme për të menduar së pari se cilat kompetenca synohen të zhvillohen tek studentët. Pra, hapi i parë për të vendosur për metodën e vlerësimit është të analizohen rezultatet e të të nxënit për kursin e caktuar. Duhet të shqyrtohet secili prej rezultateve të të nxënit dhe të identifikohen shkathtësitë të cilat kërkohen nga studentët të demonstrojnë. A kërkohet të demonstrohen njohuri specifike për lëndën e caktuar, shkathtësi praktike, apo shkathtësi gjenerike? Varësisht nga rezultatet e të nxënit, duhet të mendohet nëse kanë të bëjnë me nivelin e lartë, të mesëm, apo të ulët të të menduarit.

Një kurs i cili është i dizajnuar duke pasur në fokus të nxënit e studentëve përfshinë një qasje të avancuar dhe komplekse të vlerësimit. Një vlerësim i tillë duhet të përmbajë një grup metodash të cilat mundësojnë vlerësimin e kompetencave dhe shkathtësive të ndryshme të studentëve. Është e rëndësishme që studentët të informohen për kriteret dhe standardet që do të përdoren për të vlerësuar punën e tyre. Në Shtojcën 2 janë paraqitur disa shembuj të mënyrave të vlerësimit të studentëve në përshtatshmëri me rezultatet e të nxënit.

Shtojca 1. Shembuj të teknikave të mësimdhënies

Metodologjia	Teknika	Aktiviteti
E bazuar në ligjërimit	Ligjeratë ndërvepruese	<ul style="list-style-type: none"> • Harta të koncepteve – është një aktivitet që mund të përdoret për të paraqitur në mënyrë vizuale përbajten e ligjeratës duke treguar lidhjen në mes të koncepteve dhe ideve të diskutuara në ligjeratë • Shënime udhëzuese – janë shënime të përgatitura paraprakisht nga mësimdhënësi me informacione bazë për temën e cila ligjërohet por që kanë hapësira specifike që duhe të plotësohen nga studentët me fakte, informacione ose koncepte kyce rreth temës e cila ligjërohet. • Mendo-diskuto-ndaje – është një aktivitet që mundëson studentët të mendojnë në mënyrë të pavarur dhe komunikojnë me të tjerët. Mësimdhënësi shtron në pyetje të hapur lidhur me temën që studentët të mendojnë në mënyrë të pavarur për disa minuta. Pastaj ndahen në çift ose në grup dhe diskutojnë pyetjen për 2-5 minuta. Në fund, diskutimi realizohet me të gjithë klasën ku studentët ndajnë mendimet dhe idetë e mbledhura. • Sondazhe – mësimdhënësi përgatit pyetje lidhur me temën e ligjeratës dhe gjatë ligjërimit, paraqiten pyetjet për të marrë përgjigjet e studentëve. • Shkrimi një minutësh – është një aktivitet që mund të realizohet gjatë orës së ligjeratës ose në fund ku kërkohet nga studentët të shkruajnë për 1 minut në mënyrë anonime për ndojnë aspekt të asaj ligjerate dhe i dorëzojnë përgjigjet tek mësimdhënësi. Nga studentët mund të kërkohet të shkruajnë gjërat kryesore që kanë mësuar gjatë ligjeratës, të përshkruajnë si e kanë kuptuar ndonjë koncept të caktuar, pikat e paqarta të asaj ligjerate, përshtypjet për ndonjë aktivitet të realizuar në klasë etj.

	Diskutim	<ul style="list-style-type: none"> • Tabela e diskutimeve – përmes platformave online mësimdhënësit mund të nxisin dhe inkurajojnë diskutime në mes të studentëve për një temë të caktuar duke parashtruar pyetje për diskutim. • Të mësuarit e bazuar në skenar – përdor skenarë ndërveprues për të mbështetur strategjitë e të mësuarit aktiv. Përfshinë studentët të punojnë në ndonjë skenar apo problem kompleks të bazuar në jetë reale të cilin duhet ta zgjidhin duke aplikuar njohuritë e marra në kursin e caktuar, të menduarit kritik dhe shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve. • Seminari Sokratik – një aktivitet që mundëson studentëve të analizojnë në mënyrë kritike idetë, çështjet, dhe vlerat e paraqitura në një tekst përmes diskutimit në grup. Studentët e kanë përgjegjësinë për të udhëhequr diskutimin.
E bazuar në kërkim	Mësim në grup	<ul style="list-style-type: none"> • Projekte hulumtuese – një aktivitet që mundëson studentët të punojnë në grupe për një problem të caktuar duke mbledhur dhe analizuar të dhënat e dorës së parë të mbledhura nga studentët. • Analiza të rasteve të studimit – është aktivitet që mundëson studentët të bëjnë eksplorime të thella dhe shumëanshme të çështjeve komplekse të situatave të jetës reale. Studentët kërkohet që të hulumtojnë në problem, shqyrtojnë alternativa të ndryshme të zgjidhjes së problemit, dhe të ofrojnë zgjidhjen optimale duke përdorur dëshmi apo të dhëna. • ‘Fishbowl’ – një aktivitet që mundëson diskutime në grupe të vogla dhe të mëdha. Studentët ndahen në dy grupe, grupi (rrethi) brendshëm dhe grupi (rrethi) jashtëm. Studentët në grupin e brendshëm diskutojnë rreth një teme të caktuar kurse studentët në grupin e jashtëm dëgjojnë diskutimin dhe marrin shënime dhe ofrojnë këndvështrimet e tyre duke u bazuar në këndvështrimet e ndryshme që kanë analizuar. • Mendo-Shkruaj-Ndaj – është një aktivitet që u ofron studentëve kohë për të menduar në mënyrë të strukturuar për një temë apo problem të caktuar. Studentët formulojnë dhe i shkruajnë mendimet e tyre individuale, pastaj punojnë në çift për të zgjidhur problemin dhe në fund i ndajnë idetë

		e tyre me të gjithë klasën.
E bazuar në përvojë	Eksperiencë jashtë klasës	<ul style="list-style-type: none"> • Punë vullnetare (shërbim në komunitet) – mundëson që të kombinohen qëllimet e kursit me punën në komunitet në mënyrë që studentët të zhvillohen dhe të kontribuojnë për të mirën e përbashkët. Kjo realizohet përmes implementimit të projekteve të hartuara përmes bashkëpunimit ndërmjet fakultetit dhe partnerëve të komunitetit, si organizatat joqeveritare ose institucione tjera relevante. Përmes projektit studentët duhet të aplikojnë përmbajtjen e kursit në aktivitetet e bazuara në komunitet. Kjo u jep atyre mundësi të mësojnë përmes përvojës në kontekste të botës reale dhe të zhvillojnë përgjegjësinë e angazhimit të komunitetit. • Debate – një aktivitet që inkurajojnë studentët të zhvillojnë të kuptuarit e tyre rreth përmbajtjes së kursit dhe ta lidhin atë me përvojat ose njohuritë e tyre. Debati kërkon që studentët në mënyrë individuale ose në grup të hulumtojnë mbi tema të caktuara, të formulojnë mendimet e tyre të bazuara në të dhëna, të dëgjojnë aktivisht këndvështrime tjera, dhe të prezantojnë argumente logjike për të mbrojtur qëndrimet e tyre. • Vizita në terren – një aktivitet që mundëson mësimdhënien dhe të nxënit të ndodhë jashtë mureve të klasës për të inkorporuar ekperiencat jashtë klasës në një kurs të caktuar. Vizitat organizohen në institucione relevante që ofron studentëve përvojë reale lidhur me temën që ligjërohet duke afruar kështu më shumë teorinë me praktikën.

Shtojca 2. Shembuj të formave të vlerësimit

Rezultati i të nxënit	Vlerësimi
<p>Të menduarit kritik dhe analitik (<i>Ndërtimi i argumenteve, reflektimi, vlerësimi, gjykimi</i>)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ● Ese reflektive ● Ese argumentuese ● Rast studimi ● Raport ● Memo për një standard/udhëzues/politikë ● Analizë e një libri apo materiali të shkruar ● Analizë e një këndvështrimi teorik të një artikulli
<p>Zgjidhja e problemeve dhe zhvillimi i planeve (<i>Identifikimi i problemeve, definimi i problemeve, analizimi i të dhënave, planifikimi, aplikimi i informacionit</i>)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ● Skenari i problemit ● Punë në grup/projekt ● Puna e bazuar në problem ● Analizë e një rasti
<p>Demonstrimi i njohurive të lëndës</p>	<ul style="list-style-type: none"> ● Kuize të kohëpaskohshme ● Test me shkrim (pyetje të hapura dhe të mbyllura) ● Ese ● Raport rreth një teme të caktuar
<p>Komunikimi (<i>Komunikimi i njëanshëm dhe i dyanshëm, komunikimi verbal, joverbal, dhe me shkrim</i>)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ● Prezantim me shkrim (ese, raport, punim reflektues, etj.) ● Prezantim me gojë ● Punë në grup ● Diskutim/debat/lojë me role ● Vëzhgimi i praktikës profesionale reale ose të simuluar

**Shënim: Listat e paraqitura në shtojcë nuk janë lista të plota. Aty janë paraqitur vetëm disa shembuj të teknikave të mësimdhënies dhe vlerësimit të cilat mund të merren si shembuj orientues. Sipas nevojës mund të përdoren edhe metoda të tjera të mësimdhënies dhe të vlerësimit të cilat ndërlikohen dhe përshtaten me përmbajtjen e kurseve.*